

Kuvendi i Kosovës  
Seanca Plenare e Kuvendit  
Seanca nr.2002/19  
Prishtinë, më 07 nëntor 2002, ora 10:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

## PROCESVERBAL

Mbledhjen e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit.  
Kryesuesi pasi konstataoi numrin e deputetëve prezantë në seancë gjithsejë 98, propozoi këtë

## R E N D TË D I TË S

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Procesverbali nga seanca e kaluar;
- 3.Shqyrtimi i "P/ligjt për Inspektoratin e Punës-2002/9";
- 4.Parashtrimi i pyetjeve.

### 1.Miratimi i rendit te dites

**Sabri Hamiti:** Në një kontratë kushtetuese të Serbisë e të Malit të Zi, në preambulë është imlikuar Kosova duke u përpjekur që të paragjykohet statusi i saj i ardhshëm statusi i saj i ardhëshëm politik.

E gjykojmë këtë si një provokim, për më tepër do të thosha, një agresion kushtetues ndaj Kosovës.

Është edhe një e keqe që në hapa më të hershëm, qoftë si pjesëmarrës apo përkrahës është implikuara në të edhe Bashkësia Evropiane përmes Solanës.

Unë kërkoj sot që kjo cështje kaq e rëndësishme të vëhet me procedurë të shpëjtë në rend dite të Kuvednit dhe në fund të hartohet dokumenti përkatës.

**Fatmir Limaj :**Parlamenti, si organ më i lartë i Kosovës, duke marrë parasysh zhvillimet e fundit që kanë të bëjnë lidhur me Kosovën, ne mbështesim qëndrimin paraprak që kjo cështje e rëndësishme të futet në rend të ditës dhe ky Parlament dhe deputetët e Paralamentit të Kosovës, ta thënë fjalën e tyre, fjalën të cilën e kanë obligim ta paraqesin qëndrimin e qytetarëve të Kosovës, dhe t'i mbrojnë interesat e qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, në emër të Grupit parlamentar të Pritsë Demokratike të Kosovës edhe ne kërkojmë që kjo pikë e rendit të ditës sa më shpjet të shtrohet dhe të jetë një ndër pikat kryesore dhe të hapet debat për këtë cështje nga debati nga i cili do të delë dokumenti.

**Rada Trajkovic:** dëshiroj t'i paraqes qëndrimet e kolacionit „Kthimi”.

Ju e dini që Rezulata 1244 është aprovuar nga vendët më të rëndësishme të Kombeve te Bashkuara. Për ate dokument kaherë e kanë dhënë mendimin e vëtë organet shtetërore të Jugosllavisë dhe Sërbisë. Kuvendi i Kosovës asnjë herë nuk është deklaruar lidhur me këtë Rezulutë. Mendoj që do të ishte shumë mirë që sotë në rendë të ditës të vihet si pikë deklarimi i Kuvendit të Kosovës për përkrahjen e Rezulutës 1244.

**Bujar Dugolli:** gjatë këtyre ditëve ka pasur reagime të institucioneve të Kosovës, por fatmirsishtë dje ka reaguar ndaj kësaj që u ngrit Grupi parlamentar i LDK-së dhe i PDK-së ndaj këtij provokimi që i është bërë Kosovës, ka pasur reagime edhe nga qarqet tjera ndërkombëtare të cialt ne i pëshëndesim dhe i falenderojmë që po i tregojnë Sërbisë me atë dokument që e ka hartuar se nuk është e drejtë e tyre të përzihen në punët e Kosovës dhe të prejudikojnë statusin e Kosovës.

Ne si grup parlamentar i Alenacës për Ardhmërinë e Kosovës, kërkojmë që kjo cështje të futet në rendin e ditës dhe pas një debati të miratohet një rezolutë për këtë cështje.

**Mahir Yagcilar:** Kosova qeverisët nga administrata e OKB-së në bashkpunim me organet e përkohshme vetëqeverisesse të Kosovës. Partia Demokratike Turke i mbështetë propozimet e tri gurpeve parlamentare (LDK, PDK, AAK) është që kjo cështje të shqyrtohet në rendin e ditës.

Kryesuesi hodhi në votim propozimin e grupeve parlamentare, që rendi i ditës të plotësoshet edhe me pikën: miratimi i Rezulutës së Kuvenditë të Kosovës për kundërshtimin e përfshirjës së Kosovës në preambulën e Projekt-Kartës Kushtetuese të Unionit Sérbi-Mali i Zi.

Rezultati ishte:

Për-----80;

Kundër-----18;

Abstenuan----0.

**Rada Trajkovic:** dëshiroj që Kuvendit të votoj edhe për propozimin tim.

Kryesuesi: Kosova administrohet nga Rezulata e OKB-së dhe të gjitha institucionet e saja janë ndërtuar në bazë të sajë.

**Bajram Kosumi:** propozimi i znj.Trajkovic nuk meriton të votohët .

**Hidajet Hyseni:** propozimi i znj. Trajkovic nuk është në harmoni me procedurën e Kuvenditë.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e znj.Trajkovic.

Rezultai ishte :

Për -----0

Konstatim: askush nuk e përkrahu propozimin e sajë.

Deputetët e kolacionit „Kthimi” në shenjë proteste e lëshuan Seancën Plenare.

## 2. Procesëverbali nga seanca e kaluar.

Kryesuesi i pytë të pranishmit se a kanë vërejtje në procesëverbal?  
Askush nuk pati vërejtje dhe u miratua nga të pranishmitë .

## 3. Rezulata e Kuvendit ë të Kosovës për kundërshtimin e përfshirëjes se Kosovës në preambuluën e Projek-Kartës Kushtetuese të Unionit Sérbi-Mali i Zi.

Debati:

**Edita Tahiri**, tha se po ballafaqohemi me politikën destruktive Sérbe dhe Bashkësia Ndërkombëtare duhet të jetë më e vendosur kundër sajë. Përfshirja e Kosovës në propozimin e Kartës-Kushtetuese të Unionit Sérbi-Mali i Zi, devalvon të gjitha të arriturat e gjërë tanishme në Kosovë. Institucionet e Kosovës duhen të jenë më vigjilentë që një politike të tillë destruktive të mos ketë pasoja për Kosovën. Ajo pati edhe disa sygjerime, të cilat janë bashkangjithur Transkriptit.

**Shefki Sejdiu**, tha se për cështjën e Kosovës janë relavatë tre faktorë:a) faktori sllav, b) faktori vendor, dhe c) faktori ndërkombëtarë. Për deri sa të mos ndërgjesohën të gjithë këta faktorë do të kemi një pozitë shumë të vështirë në qendër të Evropës në shekullin e 21-të. Kosova kurrë nuk ka qenë etnikishtë sllave por ka qenë administruar dhe okupuar nga Sërbia.

**Sylejman Qërkezi**, ndër të tjerat theksoi se duhet të dilët me qëndrimet tona pa marrë parasysh se a i pëlqejnë faktorit ndërkombëtar a jo. Ky Kuvend, th ai duhet të diskutoj edhe qështjën e decentralizimit.

**Naim Maloku**, tha se nga debati ynë duhet të del zëri i arsyes, por i vendosur. Sërbia ka humbur të drjetën që të vendosë për Kosovën. Ai propozoi që Kuvendi të merr qëndrim të quartë lidhur me agresionin Kushtetues të Sérbisë. Të përgaditët Kushtetuta e Kosovës dhe të shpallët pavarsia e sajë nësë Bashkësia Ndërkombëtare e përkrah Sërbinë.

**Alush Gashi**: tha se që Kuvenditë t'i jep mbështetje deklaratave të kryetarit të Kosovës, kryeministrat, të kryetarit të Kuvenditë dhe të z. Shtajner që të gjithë e kanë kundërshtuar përfshirjen e Kosovës në aktin e Unionit Sëri-Mali i Zi.

**Ramush Haradinaj**, tha se Kosova dhe populli i sajë kanë vënë prova të mëdha se janë për paqë dhe stabilitetë në rajon. Përfshirja e Kosovës në Kartën Kushtetuese të Unionit Sérbi-Mali i Zi është një agresion kushtetues. Kuvendi Kosovës duhet të miratoj një Rezulut kundër këtij agresioni.

**Ismail Kurtoshi**, tha se Kuvendi i Kosovës të kërkoi nga z.Shtajner që ai dhe UNMIK-u menjëherë t'i ndërpresë të gjitha kontaktet me përfaqësuesit e institucioneve shtetore të Sérbisë derisa ajo nuk e hjeq tekstin nga preambulla e Kushtetusës së sajë me të cilën Kosova përfshihet si pjesë e sajë.Njashtu,të kërkohet nga KS i OKB-së,BE-ja dhe SHBA-të që ta shpallin të pavleshëm atë dokument dhe të ndërmarrin masa ndëshkuese ndaj Serbisë.

**Sabit Rustemi**, tha se Bashkësia ndërkombëtare ende nuk po vetëdijësohet me politikën destruktive sérbe. Ajo ende vazhdon të lejoj opstrukcionet të Beograditë, sikur që aprovoj më herët marrveshjën kufitare në mesë të Sérbise dhe Maqedonisë në dëmë të Kosovës.

**Hajredin Kuqi**, tha se i a.sh.q. Unioni Sérbi-Mali i Zi me këtë aktë kanë dashur që të destabilizojnë skenën politike në Kosovë, por nuk do të i'a arrinë këtij qëllimi.Shqipëtarët të Kosovës dhe të tjerëve me përashtim të sérbëve, nuk e kanë kuptuar rezulutën 1244 si një status quo, që duhem i kthehem prapë nënë Sérbi .Por në atë Rezulutë qfarë thuhët edhe në pikën e 11-të të sajë ti ipet shancë një proqesi politikë për zgjidhjën e statusit final të Kosovës. Mua më intereson kush do të udhëheqë në Kosovë pas mandatit të UNMIK-ut?Në këtë drejtim do të jemi shumë të kujdesëshum, të kemi sqarime edhe nga z.Shtajner, nga Këshilli i Evropës dhe nga Këshilli i Sigurimit.deklaratat e udhëheqësëve tanë duhet tëjenë në vazhdën e deklarimeve që i dëshirojnë qytetarët e Kosovës,përkatësisht Kuvendi i Kosovës.

**Fatmir Sejdiu**,tha se Kuvendi i Kosovës duhet të jap qëndrimin e vet ndaj këtij kërcnimi,i cili njëherit është edhe një agresion në vetë qenien e Kosovës. Kuvendi i Kosovës me ndihmën e Bashkësisë ndërkombtare ka bërë hapa seriozë në ndërtimin e institucioneve demokratike,por ka përpjekje të vazhdueshme të Beogradit që Kosova të kthehet në të kaluarën dhe për te të vendosin të tjerët.Serbia asnjëher s'ka pasur të drejtën e vendosje për kosovën.Serbia vazhdimisht ka bërë agresion ndaj Kosovës.Kuvendi i Kosovës duhet të dalë me përgjigje të vet kundër këtij provokimi.

**Xhevati Neziri**,tha se e përahë miratimin e një Rezolute nga Kuvendi i Kosovës kundër Kartës kushtetuese të Unionit Serbi-Mali i Zi.Pushteti i Sérbisë patë luajtur me komunitetet e ndryshme për ta shtirë përcarjen e tyre me shquptarët,theksoi z.Neziri .Komuniteti egjiptas do t'i përkrahë deri në fund në realizimin e aspiratave të qytetarëve të Kosovës.

**Hasan Meta** bëri një vështrim situatës së krijuar pas përfshirjes së kosovës në tekstin e preambullës së Kartës kushtetuese të Unionit Serbi-Mali i Zi dhe shprehu shqetësimet e veta.Ai i bëri një vështrim dispozitave të Kartës së OKB-së,Deklaratës së Kombeve të Bashkuara për pranimin e pranimin e popujëve të kolonizuar nr.1514 (1960),Rezolutës së KS të OKB-së nr.1244(1999),Kornizës Kushtetuese përvetëqeverisëje të përkohshme në Kosovë.Nuk jam,tha ai që Kuvendi i Kosovës të miatojë Rezolutë kundër agresionit kushtetues serb,po që ky Kuvend të miratoi Propozim-ligjin përmbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të Kosovës,të cilin e ka hartuar Lëvizja Popullore e Kosovës.Teksti integral i propozimit i është bashkangjitur Transkriptit.

**Xhavit Haliti**, tha se kemi të bëjmë me një propozim konkret që të miratohet një Rezolutë e këtij Kuvendi e cila kundërshton preambullën e Kartës kushtetuese Serbi-Mali i Zi në të cilën përfshihet territori i Kosovës si pjesë e tyre dhe të fillohet me procedurën e miratimit të sajë me të cilën shprehen shqetësimet e këtij Kuvendi rrëth preambullës së Kushtetutës Serbi-Mali i Zi.

**Edi Shukriu**, tha se e mbështet propozimin e miratimit të një rezolute e cila do ta kundërshtonte preambullën e Kartës kushtetuese Serbi-Mali i Zi, e cila paragjykon zgjidhjen e statusit rë Kosovës. Toleranca e Bashkësisë ndërkombare ndaj Serbisë, tha ajo, po i kalon kufijtë e veprimit demokratik. KFOR-i dhe UNMIK-u e lejuan ndarjen e Mitrovicës, lejuan krijimin e enklavave serbe, të cilat mbajtën gjallë shpresën e serbëve se Beograd mund të sundoi përsëri me Kosovën.

**Berat Luzha**, tha se ne tekstin e rezolutës të përfshihet edhe cështja e të burgosurëve shqiptar në burgjet e Serbisë. Në serbi gjenden rrëth 1.600 kufoma të shqiptarëve. Kjo, tha z. Luzha, është një absurd i llojit të vet.

**Mevlyde Saraci** i mbështeti kërkesat e parafolsëve për miratimin e një Rezolute në Kuvend dhe propozoi që të formohet komisioni për përgaditjen e teksit të Rezolutës e pastaj të votohet për te.

**Drita Statovci**, tha se duhet veprojë edhe në situata të parashikueshme. Ajo i mbështeti të gjitha diskutimet që ishin në fryshtë e miratimit të Rezolutës për ta kundërshtuar preambullën e Kartës kushtetuese të Unionit Serbi-Mali i Zi.

**Mahir Yagcilar**, tha se përfaqësuesit e Partisë Demokratike Turke janë për miratimin e një Rezolue me të cilën kundërshtohet përfshirja e Kosovës në Kartën kushtetuese të Unionit Serbi-Mali i Zi.

**Ramadan Kelmendi**, tha se mbështes propozimet e grupeve parlamentare që të miratohet një Rezolutë kundër përfshirjes së Kosovës në kartën kushtetuese të Unionit Serbi-Mali i Zi. Por, ai kujtoi se Sebria ka miratuar një dokument zyrtar rrëth administrativ të Mitrovicës veriore. Kuvendi duhet të reagojë për këtë dhe të miratojë Ligjin për organizimin teritorial të Kosovës.

**Sabile Basha**, th se nga ne shqiptarët vazhdimisht kërkohet që ta harrojmë të kaluarën, por ata që e harrojnë të kaluarën janë të denuar që ta përsërisinatë. Historikisht, vazhdoi ajo, edhe në Kuvendin e Prizrenit (1945), edhe më 1968, edhe më 1989 shqiptarët asnjëherë nuk vendosën që të ngelin në kuadër të serbisë dhe të ish Jugosllavisë. Vendimet e marrura pa ne (për ne) i takojnë historisë, por në të ardhmen jo të largët, potencoi ajo, është e udhës që në këtë Kuvend të shتروhet cështja e aktit final-pavarësisë së Kosovës.

**Fatmir Rexhepi**, tha se përfshirja e Kosovës në Kartën kushtetuese të Unionit Serbi-Mali i Zi është një agresion i ri mbi Kosovën, kjo është goditja më e rëndë që i është

bërë zhvillimit të proceseve në Kosovë.Jam në mbështetje të plotë,vazhdoi ai,të Deklaratës e cila shprehëkundërshtimin ndaj këtij akti kushtetues.

**Arsim Bajrami**,tha se Kuvendi i Kosovës,duke pasur parasysh debatin shumëerbajtësor dhe konsesual jo vetëm nga deputetët shqiptar,por edhe nga deputetët e komuniteteve e tjera,të përgadisë një Rezolutë,në të cilën do të shprehim qëndrimin politikë të Kuvendit të Kosovës.Kuvendi i Kosovës,vazhdoi ai,ka të drejtë të plotë legjitime të shprehë qëndrimin refuzues dhe njëkohsisht prej neve kërkohet që të jemi vigjilent,t'i përcjellim zhvillimet politike,varësisht nga rrëdhjedha e tyre ne do të marrim pozicione të reja,pra që të jemi të përgaditur që ne ta zgjidhim zgjidhim statusin final, e jo të tjerët-të përgaditemi edhe për deklarimin e pavarsisë së Kosovës.

**Kryesusi** dha një orë pauzë dhe ftoi antarët e Kryesisë dhe shefat e grupeve parlamentare që t'i harmonizojnë qëndrimet në formulimin e tekstit të Rezolutës.

Në vazhdimin e punës së seancës,kryesusi e ftoi deputetin Fatmir Sejdien që në emër të grupit hartues ta paraqes tekstin e Rezolutës:

Fatmir Sejdju:

#### KUVENDI I KOSOVËS,

-duke u nisur nga pika 11 e Rezolutës 1244 e KS të OKB-së,e cila parasheh për Kosovën një vetëqeverisje substancialë deri në zgjidhjen e statusit final të Kosovës;

-duke u nisur nga përcaktimi i Kornizës Kushtetuese për vetëqeverisjen e përkohshme e cila parasheh zgjidhjen e statusit final të Kosovës në një fazë të mëvonshme,duke marrë për bazë vullnetin e popullit;

-duke vërejtur përpjekjet e e të a.q.t. Union i Serbisë-Mali i Zi,që nëpërmjet Kartës kushtetuese,të krijojnë bazë kushtetuese për aneksimin e Kosovës;

-duke konstatuar se veprimet e këtilla janë të papranueshme për popullin e Kosovës dhe paraqesin rrezik për paqen dhe stabilitetin në Kosovë,në rajon dhe më gjërë Kuvendi i Kosovës në mbledhjen mbajtur më 7 nëntor 2002, miraton këtë

#### R E Z O L U T Ë

I.Kuvendi i Kosovës shpall të papranueshme dhe të pavleshme përcaktimet kushtetuese të shprehura në Kartën kushtetuese të të a.t.q. Union Serbi-Mali i Zi lidhur me Kosovën.

II. Kuvendi i Kosovës rikonfirmon qëndrimin se statusi final juridik i Kosovës do të përcaktohet në një fazë të mëvonëshme nga institucionet demokratike dhe populli i Kosovës në bashkëpunim me faktorët ndërkombëtar.

III.Kuvendi i Kosovës kërkon nga KS i OKB-së,BE-ja dhe faktorët e tjera ndërkombëtar që t'ju kundërvihen përpjekjeve të Serbisë dhe Malit të Zi për të prejdisikuar statusin e ardhshëm të Kosovës dhe aneksimin e sajë,tendeca këto që rrezikojnë paqën dhe stabilitetin në rajon dhe më gjërë.

IV. Kuvendi i Kosovës me vëmendje të posacme do t'i përcjell zhvillimet e mëtejshme dhe qëndrimet e Bashkësisë ndërkombëtare ndaj këtij provokomi që i bëhet Kosovës dhe do të marrë vendime adekuate.

**Kryesusi** e hodhi në fotim tekstin e Rezolutës dhe rezultati ishte:

Për-----64

Kundër-----0

Abstenuan----1.

#### 4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Inspektoratin e Punës

**Kryesuesi** ftoj z. Ahmet Isufin, Minister i punës dhe mirëqenjes sociale, që të jepë fjalën hyrëse lidhur me këtë Projektligj.

**Ahmet Isufi**, ministër i punës dhe mirëqenjes sociale, në ekspozeun e tij lidhur me leximin e parë te Projektligjit për Inspektoratin e punës, theksoi se me aprovimin e Ligjit themelor të punës, janë krijuar kushtet për themelimin e Inspektoratit të punës. Inspektorati i punës, sipas dispozitave të këtij Projektligji, ka për detyrë që të bënë mbikëqyrjen e aplikimit të dispozitave të Ligjit themelor të punës, të sigurisë në punë, mbrojtjës së shëndetit të të punësuarvedhe mbrojtjen e ambientit të punës. Në vazhdim ai theksoj se për koordinimin e këtyre detyrave, autoriteti i inspektoratit të punës, si agjensi ekzekutive ne kuadër të Ministrisës së punës dhe Mirëqenjës sociale, do të themelohet në tërësi në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr 2001/19. Në vazhdim zoti Ministër elaburoi përbajtjen e dispozitave të ketij Projektligji, nen për nen, me propozim që i njejti sot të miratohet në parim.

Pastaj **Kryesuesi**, hapi debatin lidhur me shqyrtimin në parim të Projektligjit për Inspektoratin e punës.

**Sabile Bashë**, në fillim të diskutimit, ndër të tjera i dha përkrahje miratimit në parim të këtij projektligji më rëndësi të veqantë për Kosovën. Në vazhdim, ajo kishte edhe verejtje dhe propozime konkrete per plotësim dhe ndryshim të disa dispozitave të projektligjit, të cilat janë pjesë përberëse në transkripin e kësaj seance.

**Ramadan Kelmendi**, e vlërësoj si shum të rëndësishëm nxjerrejen e ketij Ligji me qëllim të eliminimit të shum shkeljeve dhe keqëpërdorimeve të cilat ndodhin në lëmin e punësimit. Në vazhdim, ai propozoj ndryshimet dhe plotësimet konkrete, të cilat janë pjesë përberëse të Transkriptit nga kjo seancë.

**Kryesusi**, kërkoj nga deputetet që propozimet konkrete dhe amandamentet tjera të bëhen në proceduren e mëtejme .

**Tomë Hajdaraj**, në fillim të diskutimit të tij, theksoj se Komisioni për mirëqenje sociale, i ka dhenë përkrahje parimore nxjerjës së këtij Ligji, ndërsa në vazhdim ai shprehu shqetësimin lidhur me largimin e një numri të madh të punëtorëvë me rastin e privatizimit

të shumë ndërmarrjeve shoqërore si dhe shqetsimin lidhur me punësimin ,siq tha ai, vertikal të minoritetit serb ne Brezovicë, nga ana e UNMIK-ut.

**Sahit Krasniqi**, theksoi mangësit gjuhësore në tekstin e projektligjit si dhe paqartësitetë e kompetencave të inspektoratit të punës me kerkë që ato të definohen më mirë.

**Zylfije Hundozi**, tha se më së miri do të ishte që se pari irregullorja ekzistuese epërt punë të shëndrrohej në Ligj më përbajtësor, veqmas sa u përket të drejtave të nënave dhe grave. Pastaj ajo u përqendrua në vrejtjet komnkrete për përmirësimin e tekstit të këtij projekligji.

**Naim Maloku**, përkrahu miratimin në parim të projektligjit dhe shprehu dilemat rrethë autorizimeve të inspektorit të punës për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve nga punëdhënësit që nuk i kryejnë detyrimet ndaj punëtorit. Deputeti pati edhe propozim konkret për plotësim të nenit 2. dhe 5.2 të Projektligjit.

**Fatmir Sejdiu**, pasi theksoi përkrahjen në parim të Projektligjit, kerkoi nga Qeveria uniformitet në hartimin e ligjeve nga aspekti teknik, strukturor gjuhësor dhe terminologjisë së përdorur. Ne vazhdim, ai theksoi vrejtjet konkrete ne dispozitat e këtij projektligji, të cilat janë pjesë përberëse të transkript nga kjo seancë.

**Besa Gaxherri**, i dha mbeshtetje parimore dhe njëherir përkrahu vrejtjet e deputetëve tjerë. Ajo propozoj qe Qeveria si propozuese e Projektligjeve të jep shumen buxhetore të qdo ligji të cilën pastaj konform pikës 9.1.11. të Kornizës Kushtetuese, do ta shqyrtoj edhe Komisioni për buxhet. Në vazhdim, ajo elaburoi edhe vrejtjet konkrete në projektligji.

**Ibush Jonuz**, theksoi përkrahjen në parim duke theksuar se e veqanta e tij qendron në kthimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjen e të punësuarve. Megjithëate ai propozoj edhe vrejtje konkrete për plotësim dhe ndryshim të disa dispozitave të këtij Projektligji, të cilat janë pjesë përberëse të Transkriptit.

**Nafije Berisha**, u pajtua me diskutimet e shumices së deputetëve dhe propozoj që dispozitat ndëshkimore nga Ligji i punës është dashtë të inkorporohen në tekstin e këtij Projektligji bashkë me lloje tjera të denimeve. Do të ishte mirë që Projektligjet gjithnjë ti shqyrton Komisioni legjislativ i cili është shum më profesional.

**Ahmet Isufi**, shprehu falenderimet për angazhimin e deputetëve për të kontribuar në definimin sa më të mirë të teksit të Projektligjit për Inspektoratin e punës.

Pas përfundimit të debatit , u kalua për votim në parim të Projektligjit.  
Rezultati i votimit ishte:

Për.....	61,
Kundër .....	/
Apstenim.....	/.

## 5. Parashtrimi i pyetjeve

**Kryesuesi** konstatoj se për këtë seancë nuk është parashtruar asnjë pyetje e deputetëve konformë rregullave procedurale.

Me këtë seanca plenare përfundoi punimet e sotme.